

TRAINKOS SH.A.  
TRAINKOS  
TRAINKOS J  
Nr.No.Br. J/50  
Dt. 29.05.2026  
Fushë Kosovë - Kos



**trainkos**

**HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A.**

# **RAPORT**

## **Janar– Mars 2026**



**FUSHË KOSOVË,**  
**Prill 2026**

## PËRMBAJTJA

I.	HYRJE .....	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK-TRAINKOS SH. A. ....	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR .....	6
III.1	Gjendja financiare Janar – Mars 2026 .....	6
III.1.1	Të hyrat .....	6
III.1.2	Shpenzimet .....	7
III.2	Gjendja në para të gatshme – raportit sipas bankës më 31.03.2026 .....	12
III.3	Transaksionet e realizuara ( Janar – Mars 2026) .....	12
III.4	Bilanci i gjendjes (31.03.2026).....	14
IV.	TRANSPORTI I UDHËTARËVE .....	15
IV.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU .....	15
IV.2	Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km) .....	16
IV.3	Vonesat e trenave të udhëtarëve .....	16
V.	TRANSPORTI I MALLRAVE .....	17
V.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM .....	17
V.2	Shfrytëzimi i trenave .....	19
V.3	Efektiviteti i trenave .....	20
V.4	Neto-ton & neto-ton-kilometër të transportuar .....	20
V.5	Revokimi i trenave .....	21
VI.	MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML .....	22
VI.1	Pasqyra e performancës operative .....	22
VI.2	Spektori i Mirëmbajtjes.....	22
VI.3	Mirëmbajtja e trenave motorikë.....	22
VI.4	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese.....	22
VI.5	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese.....	23
VI.6	Intervenimet në mjetet tërheqëse.....	23
VI.7	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve.....	23
VI.8	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave.....	24
VI.9	Riparimi i vagonëve të huaj.....	24
VII.	PROJEKTET DHE PROKURIMI.....	25
VIII.	KONTESTET LIGJORE.....	28
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT .....	29
IX.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	29
IX.2	Aktivitetet në transportin e mallrave.....	29
IX.3	Aktivitetet në fushën promovuese.....	29
IX.4	Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera.....	34
IX.5	Pjesëmarrja e HK-Trainkos Sh.A. në iniciativat e BE-së.....	34
IX.6	Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante.....	36
X.	Sfidat kryesore gjatë periudhës Janar – Mars 2026 dhe veprimet për të ardhmen.....	37

## I. HYRJE

Raporti për periudhën Janar – Mars 2026, për HK-Trainkos Sh.A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të Ndërmarrjes duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet aktivitetet gjatë këtij tre mujori (Janar – Mars 2026) në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu, në këtë raport pasqyrohen vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të Ndërmarrjes për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga periudhat paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në (mos) arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë nga mungesa e kërkesës në treg, veçanërisht atyre të transportit të mallrave nga shkaku i mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore. Mbyllja e kësaj linje ka pamundësuar zhvillimin e transportit ndërkombëtar dhe transportin e brendshëm të mallrave. Newco Ferronikeli, si klienti ynë kryesor, edhe pse ishte zotuar për transport të brendshëm të mallrave, kjo nuk është realizuar.

Transporti i udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas vazhdon të bëhet me shumë vështirësi, kjo për shkak të vjetërsisë dhe gjendjes jo të mirë të mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra.

Sa i përket transportit të udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Shkup - Prishtinë (Maqedoni e Veriut) treni ende nuk është lëshuar në qarkullim për shkak punimeve që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Kjo ndërprerje e qarkullimit do të vazhdojë deri në rehabilitimin e plotë të këtij segmenti hekurudhor.

Pavarësisht vështirësive të paraqitura, HK-Trainkos Sh.A. ka vazhduar përpjekjet për të menaxhuar situatën dhe për të siguruar funksionimin e proceseve të brendshme në përputhje me mundësitë e kufizuara. Megjithatë, ndikimi i faktorëve të jashtëm, përfshirë ndërprerjet e linjave hekurudhore dhe mungesa e kërkesës për transport mallrash, ka bërë të pamundur realizimin e objektivave të Planit të Biznesit për këtë periudhë.

## II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH.A.

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK - Trainkos - SH.A. është si vijon:

<b>Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK - Trainkos - SH.A. më 01 Janar - Mars 2026</b>				
<b>Totali i të punësuarve</b>	<b>01.01.2026</b>		<b>31.03.2026</b>	
	<b>148</b>		<b>143</b>	
<b>Vlerat</b>	<b>Vlerat në numra</b>		<b>Vlerat në përqindje</b>	
<b>Datat</b>	<b>01.01.2026</b>	<b>31.03.2026</b>	<b>01.01.2026</b>	<b>31.03.2026</b>
Mosha mesatare e punëtorëve	48.16 %	47.67 %	%	
Në marrëdhënie të rregullt pune	148	143	%	
Meshkuj	128	123	84.48 %	86.01 %
Femra	20	20	13.51 %	13.98 %
Serbë	1	1	0.67 %	0.69 %
Shqiptarë	147	142	99.32 %	99.30 %
Me shkollim fillor	2	2	1.35 %	1.39 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	80	78	54.05 %	54.54 %
Me kualifikim profesional	20	18	13.51 %	12.58 %
Me përgatitje të lartë	2	1	1.35 %	0.69 %
Me përgatitje superiore	44	44	29.72 %	30.76 %
Zyrtarët e Lartë	4	4	2.70 %	2.79 %
Departamenti për Operime Hekurudhore	93	89	63.83 %	62.23 %
Departamenti i Administratës	29	28	19.59 %	19.58 %
Departamenti i Financave	3	3	2.02 %	2.09 %
Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit	7	7	4.72 %	4.89 %
Kabineti i KE-së	2	2	1.35 %	1.39 %
Zyra e Prokurimit	2	2	1.35 %	1.39 %
Njësia e Auditimit të Brendshëm	1	1	0.67 %	0.69 %
Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	7	7	4.72 %	4.89 %

**Tabela 1. Tabela e përgjithshme**

**Vërejtje:** Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë tremujorit Janar - Mars 2026 në Ndërmarrje ka pasur disa lëvizje/ndryshime të stafit. Të dhënat në muajin Mars paraqiten si në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Janar	Mars
1	Aktiv në fillimuj	148	147
2	Aktiv në fundmuaj	149	143

**Tabela 2. Numri i të punsuarve sipas kategorive**

Nr.	Emërtimi	Janar	Mars
1	Të pensionuar	1	4
2	Të larguar/shkarkuar/ vdekur	1	0
3	Të dorëhequr	0	0
4	Të punësuar	3	0

**Tabela 2.1. Frekuenca sipas kategorive**

### III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare Janar – Mars 2026
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.03.2026)
3. Transaksionet e realizuara (Janar - Mars 2026)
4. Bilanci i Gjendjes (31.03.2026)

#### III. 1 Gjendja financiare Janar – Mars 2026

Për periudhën raportuese Janar – Mars 2026, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

##### III. 1.1. Të hyrat

Gjatë periudhës Janar – Mars 2026 nga **transporti i mallrave** nuk kemi realizuar të hyra. Nuk kemi pasur të hyrave të planifikuara nga transporti i mallrave për këtë periudhë raportuese për arsye që linja e 10-të ende qëndron e mbyllur, gjithashtu edhe klienti ynë kryesor Newco Ferronikel nuk është duke realizuar të hyra nga transporti i brendshëm.

**Transporti i udhëtarëve** për periudhën Janar – Mars 2026 është realizuar në shumën totale prej 301,466.73€. Prej këtyre të hyrave, nga transporti i kontraktuar me MIT për OSHP janë realizuar 284,955.54€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve nga ME nuk kemi realizuar , ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 16,511.19€.

Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i udhëtarëve për këtë periudhë raportuese ka qenë 495,681.24€, realizimi i të cilave është arritur në shkallen prej 60.81%.

**Të hyrat nga shërbimet tjera** gjatë periudhës Janar – Mars 2026 nuk kemi realizuar në këtë periudhë.

Të hyrat totale nga kjo kategori kanë qenë të planifikuara në shumën prej 949.98.00€.

**Të hyra tjera** të cilat janë realizuar gjatë periudhës Janar – Mars 2026, kanë arritur shumën prej 9,841.25€. Këto të hyra janë realizuar në pozicionet si: të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A., në shumën prej 6,784.69€, të hyrat nga qiraja në shumën prej 2,542.37€, si dhe të ardhura nga interesi nga llogaria FLEX në vlerë prej 304.18€, të ardhura nga kompenzimi i dëmit është në vlerë 210.00€, ndërsa nga pozicioni i të hyrave nga shitjet tjera (riparimi i vagonëve) nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë. Të hyrat nga kjo kategori, krahasuar me planifikimin prej 18,300.00€, janë realizuar në shkallën prej 53.77%.

### III. 1.2. Shpenzimet

**Shpenzimet** për periudhën Janar – Mars 2026, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

**Totali i kostos së shërbimit** për periudhën raportuese është në shumën prej 146,418.27€. Planifikimi i këtyre shpenzimeve për TM1 ka qenë në shumën prej 181,125.07€ dhe arrin kuotën e realizimit në shkallën prej 80.84%.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2026.

**Shpenzimet e stafit** janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur realizimin në shumën prej 347,146.32€. Këto shpenzime kanë qenë për kategorinë paga dhe kontribute në vlerë prej 346,926.32€ , kurse ka pasur trajnime apo shpenzime tjera në vlerë 220.00€. Në total, nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar (387,500.00€) për TM1 të vitit 2026, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit në shkallën prej 89.59%.

**Totali i shpenzimeve operative** arrin shumën prej 11,278.63€, e cila është realizuar në shkallën prej vetëm 7.48% nga shuma e planifikuar prej 150,693.75€ për TM1 - 2026. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2026.

**Totali i shpenzimeve administrative** ka arritur në kuotën prej 29.68%, konkretisht në shumën prej 8,457.68€. Planifikimi për këto shpenzime për TM1-2026 ka qenë në shumën prej 28,500.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2026

**Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2026**


	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Planifikimi Janar - Mars 2026</b>	<b>Realizimi Janar - Mars 2026</b>	<b>Diferenca</b>	<b>B/C (%)</b>	<b>Realizimi Janar - Mars 2025</b>
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>C</b>	<b>D</b>	<b>E</b>	<b>F</b>
<b>A</b>	<b>Shitjet</b>					
1	Transporti i mallrave	-	-	-	-	-
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	324,999.99	284,955.54	40,044.45	87.68	244,104.78
3	TU – Ministria e Ekonomisë	152,681.25	-	152,681.25	-	152,568.75
4	TU – Shitja e Biletave	18,000.00	16,511.19	1,488.81	91.73	12,435.19
5	Shërbimet tjera	949.98	-	949.98	-	1,500.00
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	300.00	-	300.00	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	18,000.00	9,841.25	8,158.75	54.67	16,102.50
<b>I</b>	<b>TOTAL – TË HYRAT</b>	<b>514,931.22</b>	<b>311,307.98</b>	<b>203,623.24</b>	<b>60.46</b>	<b>426,711.22</b>
<b>B</b>	<b>Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve</b>					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	89,250.00	81,227.74	8,022.26	91.01	65,893.52
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	5,375.01	15,341.81	(9,966.80)	285.43	3,322.03
3	Inventar dhe pajisje	1,250.01	-	1,250.01	-	128.73
4	Material harxhues	250.00	-	250.00	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	15,000.00	631.53	14,368.47	4.21	13,020.66
6	Qasja në binarë	57,500.01	41,166.84	16,333.17	71.59	43,219.91
7	Sigurimi i palëve të treta	1,250.01	-	1,250.01	-	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	5,000.01	-	5,000.01	-	-
9	KMSH Nafta Infrakos	5,000.01	6,164.76	(1,164.75)	123.29	8,069.42
10	Servisimi i arkave fiskale	1,250.01	1,885.59	(635.58)	150.85	-
11	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	<b>TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT</b>	<b>181,125.07</b>	<b>146,418.27</b>	<b>34,706.80</b>	<b>80.84</b>	<b>133,654.27</b>
	<b>Fitimi (humbja) bruto</b>	<b>333,806.15</b>	<b>164,889.71</b>	<b>168,916.44</b>	<b>49.40</b>	<b>293,056.95</b>

	TË ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhurat jashtëzakonshme	-	-	-	-	
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	-	-	-	-	
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	
4	Të ardhurat nga grantet (investime kapitale)	122,318.76	-	122,318.76	-	
	<b>TOTAL – Të ardhurat tjera</b>	<b>122,318.76</b>	<b>-</b>	<b>122,318.76</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>C</b>	<b>Shpenzimet e stafit</b>					
1	Pagat dhe kontributet	386,250.00	346,926.32	39,323.68	89.82	340,318.83
2	Trajnime dhe shpenzime tjera	1,250.00	220.00	1,030.00	17.60	32.50
	<b>TOTAL - Shpenzimet e stafit</b>	<b>387,500.00</b>	<b>347,146.32</b>	<b>40,353.68</b>	<b>89.59</b>	<b>340,351.33</b>
<b>D</b>	<b>Shpenzimet operative</b>					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	123,568.75	467.80	123,100.95	0.38	1,933.33
2	Shpenzimet logjistike	2,500.00	1,287.33	1,212.67	51.49	713.63
3	Energjia elektrike dhe komunal	4,625.00	3,853.94	771.06	83.33	60.00
4	Kontrollimet sistematike	750.00	-	750.00	-	-
5	Marketingu	1,250.00	976.95	273.05	78.16	84.75
6	Udhëtimet zyrtare	1,250.00	-	1,250.00	-	-
7	Telefonat dhe Posta	3,000.00	1,894.56	1,105.44	63.15	1,988.74
8	Shërbimet bankare	250.00	278.82	(28.82)	111.53	157.19
9	Tatimet	10,500.00	710.61	9,789.39	6.77	3,912.00
10	Pajisje elektronike	3,000.00	1,808.62	1,191.38	60.29	275.12
	<b>TOTAL - Shpenzimet operative</b>	<b>150,693.75</b>	<b>11,278.63</b>	<b>139,415.12</b>	<b>7.48</b>	<b>9,124.76</b>
<b>E</b>	<b>Shpenzimet administrative</b>					
1	Inventar dhe pajisje	2,500.00	-	2,500.00	-	-
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	6,700.00	900.00	5,800.00	13.43	1,200.00
3	Material i zyrës	5,000.00	1,949.64	3,050.36	38.99	1,315.84
4	Material sanitar	1,625.00	385.01	1,239.99	23.69	428.96

5	Qiraja për objektet	2,750.00	1,940.11	809.89	70.55	1,547.14
6	Reprezentacioni dhe bufeja	1,500.00	597.46	902.54	39.83	949.19
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	4,750.00	-	4,750.00	41.00	-
8	Shpenzimet logjistike	1,175.00	1,765.46	(590.46)	150.25	548.95
9	Kontigjente	2,500.00	920.00	1,580.00	36.80	-
	<b>TOTAL - Shpenzimet administrative</b>	<b>28,500.00</b>	<b>8,457.68</b>	<b>20,042.32</b>	<b>29.68</b>	<b>5,990.08</b>
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
<b>I</b>	<b>TOTAL – TË HYRAT</b>	<b>637,249.98</b>	<b>311,307.98</b>	<b>325,942.00</b>	<b>48.85</b>	<b>-</b>
<b>I</b>	<b>TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)</b>	<b>747,818.82</b>	<b>513,300.90</b>	<b>234,517.92</b>	<b>68.64</b>	<b>489,120.44</b>
<b>I</b>	<b>Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit</b>	<b>(110,568.84)</b>	<b>(201,992.92)</b>	<b>91,424.08</b>	<b>182.69</b>	<b>(62,409.22)</b>
	<b>GRANTET</b>	<b>112,500.00</b>	<b>108,855.17</b>	<b>3,644.83</b>	<b>96.76</b>	<b>77,488.86</b>
<b>F</b>	<b>Shpenzimet e zhvlerësimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>			
<b>1</b>	<b>Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve</b>	<b>112,500.00</b>	<b>95,601.54</b>	<b>16,898.46</b>	<b>84.98</b>	<b>77,488.86</b>
<b>2</b>	<b>Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë</b>	<b>-</b>	<b>13,253.63</b>	<b>(13,253.63)</b>	<b>-</b>	<b>13,409.98</b>
	<b>TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit</b>	<b>112,500.00</b>	<b>108,855.17</b>	<b>3,644.83</b>	<b>96.76</b>	<b>90,898.84</b>
<b>G</b>	<b>Fitimi (humbja) nga veprimtaria</b>	<b>(110,568.84)</b>	<b>(215,246.55)</b>	<b>104,677.71</b>	<b>194.67</b>	<b>(75,819.20)</b>


**Tabela Nr. 3.1**

**Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Janar – Mars 2026**



**Diagrami Nr. 3.2**

**Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Janar – Mars 2026**



**Diagrami Nr.3.3**

### III.2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.03.2026

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31.03.2026
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	4,638.46
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	-
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	15.58
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	5.20
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	3.60
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	7.52
7	PCB nr. 1114-004229-0001-65-FLEX	25,502.73
	<b>TOTALI</b>	<b>30,173.09</b>

**Tabela Nr. 3.4**

### III.3. Transaksionet e realizuara Janar – Mars 2026

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.03.2026	198.06
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Mars 2026	404,460.04
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Mars 2026	400,019.64
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2026	4,638.46

**Tabela Nr. 3.5**

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MIT dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.03.2026	6.82
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Mars 2026	108,641.98
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Mars 2026	108,640.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2026	8.80

**Tabela Nr. 3.6**

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.03.2026	15.58
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Mars 2026	0.00
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Mars 2026	0.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2026	15.58

**Tabela Nr. 3.7**

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.03.2026	15.58
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Janar - Mars 2026	0.00
Pagesat e kryera gjatë muajve Janar - Mars 2026	0.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2026	15.58

**Tabela Nr. 3.8**

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës Janar – Mars 2026 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar - Mars 2026			Pagesat Janar - Mars 2026		
N r.	Emërtimi	Vlera	N r.	Emërtimi	Vlera
1	Deponim nga MIT	108,641.98	1	Pagesa per Pagat Mars 2026	101,627.01
2	Deponim nga KMDK	2,618.65	2	Pagesa per Pagat Janar 2026	97,209.38
3	Deponim nga llogaria FLEX	304.18	3	Pagesa per Pagat Shkurt 2026	96,929.95
4	Deponim nga Transporti i Udhëtareve	13,390.00	4	Pagesa për Kontribute Shkurt 2026	10,829.55
5	Deponim nga Kompania e sigurimeve EUROSIG (Kompenzim i Demit)	210.00	5	Pagesa për Kontribute Janar 2026	10,664.66
			6	Pagesa e Kontributeve - Dhjetor 2025	10,441.68
6			7	Pagesa e TVSH Dhjetor 2025	9,285.52
			8	Pagesa per furnit. DIARI BM SH.P.K.	8,979.80
			9	Pagesa per tatim ne page Shkurt 2026	6,030.03
8			10	Pagesa per tatim ne page Janar 2026	5,864.45
			11	Pagesa e Tatimi ne page Dhjetor 2025	5,541.25
9			12	Pagesa per Sindikaten1	860.53
			13	Pagesa e TVSH Janar 2026	247.96
			14	Pagesa per SHKÇAK/SCAAK	220.00
			15	Pagesa per Sindikaten2	603.92
			16	Pagesa për tatim në qera 2025	303.33
			17	Pagesa e Shpenzimeve te bankës	223.82
			18	Pagesa per CANVA	105.59
<b>TOTALI</b>		<b>125,164.81</b>	<b>TOTALI</b>		<b>365,968.43</b>

Tabela Nr. 3.9

### III.4. Bilanci i Gjendjes (31.03.2026)

<b>BILANCI I GJENDJES</b>		
<b>NP TRAINKOS SH.A</b>	<b>GJENDJA FILLESTARE 01.01.2026</b>	<b>GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.03.2026</b>
<b>Mjetet themelore - vlera neto sipas librave</b>	<b>1,858,034.35</b>	<b>1,791,269.65</b>
<b>Mjetet Qarkulluese</b>	<b>834,855.90</b>	<b>823,287.25</b>
Stoqet	465,025.71	484,253.67
Paraja	301,552.92	30,173.09
Llogarite e arketueshme	48,674.84	257,763.14
Kerkesa tjera te arketushme	4,254.63	35,749.55
Parapagimet	15,347.80	15,347.80
<b>Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore</b>	<b>2,692,890.25</b>	<b>2,614,556.90</b>
<b>Detyrimet afatshkurta</b>	<b>1,823,295.76</b>	<b>2,030,916.59</b>
Llogarite e pagueshme	666,778.27	876,684.69
Te pagueshme tjera - detyrime	479.91	528.30
Detyrime tatimore	791,074.58	788,740.60
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
<b>Detyrimet afatgjata</b>	<b>1,376,919.73</b>	<b>1,280,733.78</b>
<b>Kapitali</b>	<b>5,292,941.06</b>	<b>5,292,941.06</b>
Fitimi/Humbja e bartur	-5,711,180.58	5,711,180.58
Fitim/ Humbja e vitit	-63,607.39	278,853.95
<b>Total detyrimet dhe kaptali</b>	<b>2,692,890.25</b>	<b>2,614,556.90</b>

Tabela Nr. 3.10

## IV.TRANSPORTI I UDHËTARËVE

### IV.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU

Gjatë periudhës **Janar – Mars 2026** numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është 18,254 ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave dhe ID kartelat është 19,974.20 € ( me TVSH).dhe 16,927.27 € ( pa TVSH) Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2025, numri i udhëtarëve në TM1 2026 është për 846 udhëtarë më shumë, apo shprehur në përqindje +4.86 %,më shumë. Krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për - 2746 udhëtarë më pakë, apo shprehur në përqindje është realizuar 86.92% e planifikimit. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 2,048.56 € më shumë, apo +13.77 %, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për -1,072.73 € më pak , apo janë realizuar 94.04 %.e planifikimit.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për periudhën **Janar - Mars 2026** si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar,dhe planifikimin për periudhën raportuese në TM1 2026:

Sqarim : në numrin total të udhëtarëve nuk janë të përfshira kategoritë e liruara nga pagesa,këto kategori nuk paguajnë biletë ,mirëpo janë kategori të cilat frekuentojnë mjaft shumë transportin hekurudhorë.

Të dhënat për numrin e udhëtarëve për periudhën TM1 2026							
Përshkrimi	Realizim TM1 2025	Realizimi TM1 2026	Planifikim TM1 2026	Dallimi: Realizim TM1 2025 – TM1 2026	Dallimi: Realizim - planifikim TM1 2026	Dallimi në %: TM1 2025 – TM1 2026	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM1 2026
Janar – Mars	17, 408	18,254	21,000	+846	- 2746	+ 4.86%	86.92 %

Tabela Nr. 4.1

Të dhënat për realizimin financiar në transportin e udhëtarëve për periudhën TM1 2026							
Përshkrimi	Realizimi TM1 2025	Realizimi TM1 2026	Planifikimi TM1 2026	Dallimi: Realizim TM1 2025 – TM1 2026	Dallimi: Realizim - planifikim TM1 2026	Dallimi në %: TM1 2025– TM1 2026	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM1 2026
Janar –Mars	14,878.71	16,927.27	18,000.00	+ 2,048.56	-1,072.73	+13.77 %	94.04 %

**Tabela Nr. 4.2**

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër të udhëtarëve më të madhë krahasuar me vitin e kaluar por më të vogël në krahasim me planifikimin.

**IV.2 Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)**

Numri i trenave të udhëtarëve për këtë periudhë tremujore gjithsej ka qenë **541** ndërsa numri i përgjithshëm i udhëtarëve për kilometër (udhëtar/kilometër) ka qenë **759,253.00** Sa i përket totalit të kilometrave të zhvilluara nga të gjithë trenat e transportit të udhëtarëve (tren/km) ka qenë **32,644.00. dhe V/kom 40.94 km/h**

**IV.3 Vonesat e trenave të udhëtarëve**

Prej 541 trenave kanë operuar në këtë periudhë raportuese kan shkaktuar vonesa, të cilat janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0
Vazhdimi i udhëtimit	0	0
Kryqëzimet	0	0
Lokomotiva/GM defekt	0	0
Lidhja me trenin	0	0
Bashkëngjitja e vagonëve/tërheqja e mjeteve	0	0
Doganë + Polici	0	0
Pritje në garniturë	0	0
Aksidente	0	0
Në nisje	420	12.49 %
Në arritje	2943	87.51 %
Të tjera	0	0
<b>Total vonesat</b>	<b>3,363</b>	<b>100 %</b>

**Tabela Nr. 4.3**

## V. TRANSPORTI I MALLRAVE

### V.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave për periudhën janar – mars 2026 si dhe do të behët krahasimi me planifikimin dhe me realizimin për periudhën e njëjtë të vitit 2025.

Gjatë periudhës janar - mars 2026 në TM-1 2026 janë transportuar 250 neto- ton mallra nga të cilat janë realizuar 785 € keto të hyra kan qen avanc të paraqitura në vitit e kaluar në TM-4 . Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2025 TM-1, nuk është realizuar asnjë transport pra 0.00, ku planifikimi ka qën 105,000 neto-ton mallra .Sa i përket realizimit financiar ,në TM1 2025 nuk ka pasur të hyra pra 0.00€ ,ndersa në TM1 2026 janë realizuar 0.00 €. Mirëpo, nëse krahasojmë realizimin me planifikimin për TM-1 2026, është 100% mallra të transportuera ,ndersa ne TM-1.2025 janë -105,000 neto-tonë mallra, apo shprehur në përqindje, pra është 0.00% e planifikimit.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për periudhën janar - mars 2026 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe me planifikimin për periudhën raportuese në TM1 2025.

Realizimi në transportin e mallrave:

Janar- Mars 2026	Realizimi Neto Ton 2025	Realizim Neto Ton 2026	Planifikim Neto Ton 2026	Dallimi Realizim 2026/2025	Dallimi Realizim-Planifikim 2026	Dallimi Realizim 2026/2025 (%)	Dallimi Realizim-Planifikim 2026(%)
Sasia e transportuar	0.00	250	0.00	250	250	100%	100%

**Tabela 5.1**


Siç mund të shihet nga tabela 5.1, transporti është realizuar 100% ,pasi qe nuk kemi planifikuar transport ne TM-1.

Transporti i mallrave me kontejnerë për periudhën janar – mars 2026 ka qenë:

Numri i transportuar i kontejnerëve	Kontejnerë të plotë 2026	Kontejnerë të zbrazët 2026
Sasia	0.00	0.00

**Tabela 5.2**

Sasia e transportuar në neto-ton për periudhën janar - mars 2026 në formë diagrami:



**Figura 5.1**


Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Të hyrat Janar-Mars 2026	Realizim shitje të hyra 2025	Realizim shitje të hyra 2026	Planifikim 2026	Dallimi në Realizim 2026/2025	Realizim-Planifikim 2026	Realizim 2026/2025 (%)	Realizim-Planifikim 2026(%)
Vlera €	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%	0.00%

**Tabela 5.3**

Siç mund të shihet nga tabela më lart, të hyra nuk kemi pasur nuk kemi transport të planifikuar për periudhën Janar- Mars 2026.

### Të hyrat në periudhën Janar-Mars 2025 në formë diagrami



**Figura 5.2**

### Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Të hyrat dhe shpenzimet	Shitjet/të hyrat në TM	Të ardhura tjera nga TM	Total shitjet	Shpenzimet direkte në TM	Shpenzim et indirekte në TM	Total Shpenzimet	Fitimi/hu mbja operative	Fitimi/humbja në %
Vlera €	0.00	0.00	0.00	79,364.20	4,786.20	84,150.40	(84,150.40)	-100%

**Tabela 5.4**

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë 14.67% të shpenzimeve në total të kompanisë kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me trena (*tren kilometër*) në komunikacion.

### V.2 Shfrytëzimi i trenave

Për shkak të punimeve në Linjën e 10-të Hekurudhore, në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit, linja ka qenë e mbyllur gjatë gjithë kohës, Ndërsa, transporti vendor nuk është realizuar sipas planifikimeve, për shkak të mos fillimit të transportit të xehes nga Ferronikeli.

Janar – Mars 2026	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2025
Import	0	0	0.00 %
Export	0	0	0.00 %
Vendor	228	0	0.00 %
Total	228	0	0.00 %

**Tabela 5.5**

### V.3 Efektiviteti i trenave

Janar – Mars 2026	Pesha max. bartëse t/tren	Mesatarja e çdo treni - bt	Efektiviteti (%)
Import	1200	0.00	0.00 %
Eksport	1200	0.00	0.00 %
Vendor	1400	0.00	0.00 %

Tabela 5.6

### V.4 Neto-ton & neto-ton kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Janar-Mars 2026	Planifikim Janar-Mars 2026	Realizim/Planifikim 2026 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2026 (ton)
Import	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Export	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Vendor	1	0.00	100%	1,675	250
Total	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00

Tabela 5.7

### Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe manovruese – shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara

Shpenzimet e lokomotivave tërheqëse dhe manovruese -Transporti i mallrave Janar-Mars 2026							
Muaji	Shp/km	2640-007	2640-008	2710-009	2640-010	2760-001	Totali
Janar	Shp.Naftë	2,440	1,300	0.00	0,00	0.00	3,740
	Kilometrat	7	921	0.00	0,00	0.00	928
	Nafta /km	0.00	1.41	0.00	0,00	0.00	4.030
Shkurt	Shp.Naftë	1,450	4,245	0.00	0,00	0.00	5,695
	Kilometrat	1,118.40	2,326.80	0.00	0,00	15	3,460.2
	Nafta /km	1.30	1.82	0.00	0,00	0.00	1.65
Mars	Shp.Naftë	0.00	1,900	0.00	0,00	0,00	1,900
	Kilometrat	380	18	0.00	0,00	0.00	398
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	0,00	4.77
Janar – Mars 2026	Shp.Naftë	3,890	7,445	0.00	0,00	0.00	11,335
	Kilometrat	1,505.4	3,265.8	0.00	0,00	0.00	4,786.2
	Nafta /km	2.584	2.279	0.00	0,00	0.00	2.37

Tabela 5.8

## V.5 Revokimi i trenave

Janar Mars 2026	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import- Export	76	0	0	0	0.00 €
Vendor	168	60	0	0	310.45€
Total	244	0	0	0	0.00 €

Tabela 5.9

Në tabelën më lart shihet se gjatë periudhës janar – mars 2026 në import dhe eksport janë revokuar në total 76 trena me 0%, të planifikuar sipas OLT-së.

Ndërsa në transportin vendor gjatë periudhës janar – mars 2026 në total janë 60 trena të revokuar me 10%, vlera e revokimeve është 310.45 €.

Revokimet e këtyre trenave në transport vendor kanë ardhur si pasojë e mos fillimit të transportit të planifikuar nga NewCo Ferronikeli.

## VI. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE -MML

### VI.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01 Janar – 31 Mars 2026, duke krahasuar me realizimin e tre mujorin të parë (TM1) të vitit 2025.

### VI.2 Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: Mirëmbajtja e trenave motorik, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

### VI.3 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara në periudhën Janar- Mars 2026 krahasuar me periudhën Janar – Mars 2025

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar- Mars 2026	Janar- Mars 2025	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.1

### VI.4 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në periudhën Janar – Mars 2026 krahasuar me periudhën Janar – Mars 2025

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar-Mars 2026	Janar-Mars 2025	Ndryshimi
1.	Servisime	83	85	-2
2.	Riparime	16	14	+2
3.	Kontrollime K1	3	9	-6
4.	Kontrollime K3	0	2	-2
5.	Kontrollime K6	3	1	+2
6.	Gdhendja e rrotave	1	0	+1

Tabela 6.2

## VI.5 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën Janar- Mars 2026 krahasuar me periudhën Janar- Mars 2025

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Janar-Mars 2026	Janar – Mars 2025	Ndryshimi
1.	Servisime	1	0	+1
2.	Riparime	0	4	-4
3.	Kontrollime K1	0	3	-3
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	1	0	+1

**Tabela 6.3**

## VI.6 Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore (Janar – Mars 2026) për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	0	2	9	0	0	72	1	0	0
Riparime (R)	0	7	1	0	0	8	0	0	0
Kontrollime (K 1)	0	1	1	0	0	1	0	0	0
Kontrollime (K 3)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kontrollime (K 6)	0	1	1	0	0	1	1	0	0
Gdhendje të rrotave	0	0	0	0	0	1	0	0	0

**Tabela 6.4**

*Servisime – S*

*Riparime – R*

*Kontrollime njëmuajor – K1*

*Kontrollime tremujor – K3*

*Kontrollime gjashtëmuajor – K6*

## VI.7 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtareve realizuar në periudhën Janar-Mars 2026, krahasuar me periudhën Janar – Mars 2025.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar- Mars 2026	Janar – Mars 2025	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	9	11	-2
2.	Riparim në punëtori	4	20	-16
3.	Gdhendje të rrotave	1	0	+1
4.	Testim i komponentëve	0	0	0
5.	Riparime në stacion	0	0	0

**Tabela 6.5**

#### IV.8 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën Janar – Mars 2026, krahasuar me periudhën Janar – Mars 2025.

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar – Mars 2026	Janar – Mars 2025	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Riparim në teren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

**Tabela 6.6**

#### VI.9 Riparimi i vagonëve të huaj

Gjatë këtij tre mujori, Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse nuk ka pasur kërkesa për riparim të vagonëve të huaj.

Në tabelën nr.6.7, janë paraqitur vlerat e punëve të kryera për periodën Janar – Mars 2026 dhe është krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Janar – Mars 2026	Janar – Mars 2025
NewCo Ferronikeli	00.00 €	00.00 €

**Tabela 6.7**

## VII. PROJEKTET DHE PROKURIMI

Në tabelën 7.1 janë paraqitur projektet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës Janar – Mars 2026:

Nr	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat.	Koment	Periudha Tre (3) mujore
1	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting	10,800.00	10,800.00	Në implementim	TM1 2024
2	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	9,500.00	7,839.97	Në implementim	TM1 2023
3	Furnizimi me material Higjienik	5,000.00	1,482.73	Në procedurë	TM1 2025
4	Furnizimi me materiale administrative	3,300.00	2,444.02	Kontraktuar	TM1 2025
5	Furnizimi me toner për nevoja të Trainkos Sha	1,400.00	1,299.01	Kontraktuar	TM1 2025
6	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	2,000.00	1,982.40	Kontraktuar	TM2 2025
7	Mirëmbajtja e Infrastrukturës kryesore të IT-së	24,000.00	23,998.36	Kontraktuar	TM3 2025
8	Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë	24,000.00	27,144.13	Kontraktuar	TM4 2025
9	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	4,500.00	4,319.98	Kontraktuar	TM4 2025
10	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005	100,000.00	-	Anuluar	TM4 2025
11	Furnizim me rregullator ngacmimi statik për	9,000.00	8,979.80	Kontraktuar	TM4 2025

	gjeneratorin KATO në lokomotivën 645				
12	Furnizim me 5 sete komplet të diktunave për frenues indirekt Westinghouse 26C	4,000.00	3,822.00	Kontraktuar	TM4 2025
13	Shërbimet e shtypjes se orarit te lëvizjes se trenave (OLT)	300.00	194.70	Përfunduar	TM4 2025
14	Furnizimi me materiale promovuese për fundvit	990.00	837.80	Përfunduar	TM4 2025
15	Riparim i frenuesve indirekt Westinghouse 26C për lokomotivat GM G16 (661)	7,000.00	6,962.00	Kontraktuar	TM4 2025
16	Shërbime për servisimin e aparateve kundër zjarrit për vitin 2026	1,300.00		Publikuar	TM1 2026
17	Furnizim me ujë të pijshëm	3,000.00		Publikuar	TM1 2026
18	Servisimi dhe ndërrimi i setit të dhëmbëzorëve për automjetet e Kompanisë	1,500.00		Publikuar	TM1 2026
19	Pastrimi i pushtave në Objektet e Kompanisë	950.00		Publikuar	TM1 2026
20	Furnizim me sensor ( dhënës ) shpejtësie për lokomotivën 2620-005 GT22HW-2 (645)	5,000.00		B58	TM1 2026
21	Furnizim me goma dhe regllazhë për automjetet Dacia Sandero TG.01-496-NK, Hyundai TG.01-310-AE, Citroen TG.01-360-OS	999.00		Publikuar	TM1 2026

1. **Shërbimet e mirëmbajtjes se sistemit financiar PLANET Accounting-** është nënshkruar kontrata më datën 10.01.2024 dhe është projekt për 3 vite, është procedurë e negociuar pa publikim.
2. **Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025** - Projekti është kontraktuar për periudhë tre vjeçare dhe është në zbatim e sipër. Operatori Ekonomik ka përfunduar pjesën e dytë të kontratës për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2024 dhe e njëjta është faturuar.
3. **Furnizimi me material Higjienik** - është shpallur oferta fituese me të cilën është nënshkruar kontrata me O.E. PM GROUP SH.P.K. me çmim 1,482.73 €.
4. **Furnizimi me materiale administrative** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlerë prej 2,444.02 €.
5. **Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha** - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlerë 1,299.01 €.
6. **Shërbimet e sigurimit të palëve të treta** është nënshkruar kontrata me O.E.
7. **Mirëmbajtja e infrastrukturës kryesore të IT-së**, është nënshkruar kontrata me O.E dhe projekti është në implementim.
8. **Furnizimi me rroba dhe mjete mbrojtëse për punëtorë**, është nënshkruar kontrata me O.E SANKOS SH.P.K.N me çmim prej 27,144.13 eurosh.
9. **Shërbimet e abonimit te arkave fiskale**, është nënshkruar kontrata me O.E ENTERNET SH.P.K., me çmim prej 4,319.98 eurosh.
10. **Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 2620-005**, është bërë njoftimi për anulimin e projektit më datën 24.02.2026.
11. **Furnizim me rregullator ngacmimi statik për gjeneratorin KATO në lokomotivën 645**, është nënshkruar kontrata me O.E DIARI BM SH.P.K, me çmim prej 8,979.80 eurosh.
12. **Furnizim me 5 sete komplet të diktunave për frenues indirekt Westinghouse 26C**, është nënshkruar kontrata me O.E N & B SH.P.K., me çmimin prej 3,822.00 eurosh.
13. **Shërbimet e shtypjes se orarit te lëvizjes se trenave (OLT)**, projekti ka përfunduar.
14. **Furnizimi me materiale promovuese për fundvit**, projekti ka përfunduar.
15. **Riparim i frenuesve indirekt Westinghouse 26C për lokomotivat GM G16 (661)**, është nënshkruar kontrata me O.E RM In Time L.L.C., me çmimin prej 6,962.00 eurosh.
16. **Shërbime për servisimin e aparateve kundër zjarrit për vitin 2026**, është bërë njoftimi për kontratë më datën 02.02.2026.
17. **Furnizim me ujë të pijshëm**, është bërë njoftimi për kontratë më datën 03.02.2026.
18. **Servisimi dhe ndërrimi i setit të dhëmbëzorëve për automjetet e Kompanisë**, është bërë njoftimi për kontratë më datën 03.02.2026.
19. **Pastrimi i pusëve në Objektet e Kompanisë**, është publikuar dy here dhe në asnjërën herë nuk ka pasur ofertues.
20. **Furnizim me sensor ( dhënës ) shpejtësie për lokomotivën 2620-005 GT22HW-2 (645)**, hapja e tenderit është bërë më datën 11.03.2026. Kemi pranuar 4 oferta nga 4 O.E. por që

asnjëri nuk e ka ofruar produktin e kërkuar në bazë të specifikacionit teknik në dosjen e tenderit dhe tenderi duhet të shkoj në anulim.

**21. Furnizim me goma dhe regllazhë për automjetet Dacia Sandero TG.01-496-NK, Hyundai TG.01-310-AE, Citroen TG.01-360-OS, hapja e procedures minimale do të bëhet më datën 03.04.2026.**

**Sqarim:** Sa i përket Projekteve për Investime Kapitale ende nuk ka marrëveshje të nënshkruar.

## VIII. KONTESTET LIGJORE

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. në vitin 2026, pritet të ballafaqohen me **66** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale te përshkruar sipas aktivitetit ne tabelën e mësipërme:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	//////////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	10
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	29
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	5
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbarimore	20
6.	Lëndë në procedurë penale	1
7.	Totali	66

Tabela 8.1.

## IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

### IX.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Edhe këtë tre mujor sipas planifikimit kemi vazhdimësi në realizimin e trenave të udhëtarëve rrjedhimisht edhe të të hyrave nga Marrëveshja e OShP-së (2023 – 2027) për vitin 2026, nërsa këtë tre mujor nuk kemi planifikuar transport për mallra. Edhe për këtë periudhë pengesë për transportin e mallrave ashtu si në pjesën e fundvitit 2025 janë vonesat e përfundimit të punëve që janë duke u zhvilluar në modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore. Nëse e kemi parasysh se Linja e 10-të hekurudhore është arteria bazë e rrjetit hekurudhorë në dhe nga Kosova atëherë kjo është pengesë esenciale në zhvillimin e biznesit të kompanisë për transport me hekurudhë dhe realizimin e projekteve tjera po ashtu shumë esenciale për të ardhmen. Pritjet tona që Linja të lëshohet në shfrytëzim sipas orareve të paralajmëruara nuk kanë ndodhur, nga kjo vazhdon mosplotësimi i planifikimeve tona për transportin e mallrave dhe udhëtarëve sipas planifikimeve dhe kërkesave që dalin për sektorin hekurudhor nga planifikimet dhe strategjitë e shtetit të Kosovës.

### IX.2 Aktivitetet në transportin e mallrave përgjatë periudhës Janar – Mars 2026

Klienti NewCo Ferronikeli ka pasur kontrate transporti deri ne 31.12.2023 i njëjti nuk e ka vazhduar kontratën e transportit për vitin 2026:

Nr.	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NewCo Ferronikeli	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

*Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2026 janë gjithsej dy (2) partnerë. Duhet theksuar se keta partnerë që kanë nënshkruar kontratë transporti janë ndërkombëtarë, dhe të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2025, përjashtimisht klienti/partneri **Schenker DB dhe Fershped AD**.*

*Lista e partnerëve ndërkombëtarë:*

Nr	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	CARGO LOGISTC DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2	ARGO LOGISTIC INT	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

#### Sqarim:

Klienti/partneri Navico Shipping Doo, Schenker DB dhe Fershped AD, jemi në pritje të nënshkrimit të kontratës për vitin 2026.

### IX.3 Aktivitetet në fushën promovuese gjatë periudhës Janar – Mars 2026

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për

promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut. Sektori i Marketingut ka qenë gjithmonë në përcjellje të organizimeve grupore të cilat janë aprovuar dhe janë realizuar me vagonë të udhëtarëve, nëpërmjet kërkesave të veçanta për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A. Po ashtu, gjatë tërë kohës mbajmë kontakte me udhëtar aktual dhe potencial të cilët bëjnë pyetje nëpër rrjetet sociale.

### **Projektet e kampanjave të Marketingut:**

Ka filluar te realizohet projekti **RepRezent** nga Imagine Film ku çdo te mërkurë ftohen mysafire te estradës ne intervista e cila mbahet ne Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse ne Trainkos Sh.A. Emisionet publikohen ne Youtube aty përfaqësohet logo Trainkos Sh.A ky projekt do te zgjate për periudhën 15.01.2026 deri me 31.03.2026.

***Kemi filluar zbatimin e rekomandimeve te dala nga Raporti mbi Matjen e Kënaqshmërisë se klientëve te Trainkos Sh.A për vitin 2026.***

- ***Zhvillojnë strategji më efektive për komunikimin me udhëtarët, duke përdorur kanale moderne si rrjetet sociale dhe platforma digjitale.***
  - Kemi komunikuar me udhëtarët/klientët e Trainkos-it përmes rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, LinkedIn, Google Business Profile dhe Viber Community.
- ***Të krijojnë fushata marketingu që theksojnë përfitimet ekonomike dhe praktike të udhëtimit me tren, duke nxjerrë në pah çmimet e ulëta si një faktor kryesor.***
  - Kemi postuar Oraret e Lëvizjes se trenit si dhe çmimet e udhëtimeve me tren për te gjitha stacionet ne relacionin Prishtine – Pejë.
- ***Duke u përqendruar në standardizimin dhe përmirësimin e komunikimit për të siguruar që të gjithë klientët marrin informacion të qartë dhe të shpejtë për shërbimet dhe çdo ndryshim eventual.***
  - Agjentet e marketingut mbajnë komunikim te vazhdueshëm duke u përgjigje në çdo pyetje apo informatë në rrjeteve sociale Facebook, Instagram, LinkedIn, Google Business Profile dhe Viber Community.
- ***Duke informuar klientët për përmirësimet në shërbim dhe për çdo masë që po ndërmerrni për të shmangur problemet.***
  - Klientët i informojmë përmes rrjeteve sociale lidhur me pa kënaqësitë e tyre që shprehin ndaj kompanisë sonë. si p.sh. defektet e trenit , përmes videos ju tregojmë që e bëjmë çdo ditë kontrollimin dhe servisimin e lokomotivës. Ndërsa lidhur me pa pastërtinë e vagonëve përmes videos qe i postojmë në rrjete sociale ju tregojmë se si ne kujdesemi për pastrimin e Vagonëve ne vazhdimësi.

- ***Duke vazhduar të promovojnë fleksibilitetin e tarifave në komunikimet e marketingut dhe shitjeve, për të siguruar që klientët ekzistues dhe potencialë të jenë të informuar rreth këtij përfitimi të rëndësishëm.***
  - Ne vazhdimësi përcjellim oferta konkrete te transportit te mallrave dhe te transporti te udhëtarëve.
- ***Trainkos duhet të zhvillojë fushata marketingu për të informuar publikun mbi shërbimet e saj, duke theksuar avantazhet dhe besueshmërinë.***
  - Përmes rrjeteve sociale Facebook, Instagram, LinkedIn, Google Business Profile dhe Viber Community ne i njoftojmë publikun për shërbimet tona që i posedojmë, duke ju treguar qe jemi të sakt, të shpejt , të rehatshëm, të besueshëm.

Më poshtë do të prezantojmë më në detaje promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A.

Më poshtë do të prezantojmë më në detaje promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A.

### ***Rrjetet Sociale***

Në **Facebook, Instagram, LinkedIn, Google Business Profile dhe Viber Community** gjatë periudhës **Janar - Mars 2026** kemi postuar këto informacione:

- **Postim:** Njoftim për udhëtarë për rrëshqitjen e gurëve në Km 51/200 me datë 05.01.2026;
- **Postim:** Njoftim për udhëtarë, që treni do të qarkulloj normalisht me datën 06.01.2026;
- **Postim:** Njoftim falënderues për ndjekësit që kemi arrit numrin 10.000 ndjekës;
- **Profil:** Ndërrimi i foto profilit në të gjitha platformat (fb, Instagram, LinkedIn, Viber);
- **Postim:** Foto të udhëtareve në tren, gjatë aktivitetit në ditën e parë për shpërndarjen e broshurave dhe orarit te trenit;
- **Postim:** Foto të udhëtareve në tren, gjatë aktivitetit në ditën e dytë për shpërndarjen e broshurave dhe orarit te trenit;
- **Postim:** Njoftim për student! Dokumentacioni që ju duhet për tu pajisur me ID Kartelat e Trainkos-it;
- **Story:** Dallimi i biletës mes trenit, makinës, autobusit dhe taxit;
- **Story:** Çmimet dhe beneficionet Prishtinë-Seperant-Prishtinë;
- **Postim:** Beneficionet e udhëtimit;
- **Story:** Shpërndarje e të dhënave për ankesa, sugjerime apo kërkesa;
- **Story:** Çmimet dhe beneficionet Prishtinë-Arban-Prishtinë;
- **Story:** Boomerang i materialeve të fundvitit;

- **Story:** Boomerang i OLT-së (Orari i linjës se trenit)i
- **Story:** Video e trenit në lëvizje, me përshkrimin “Dritë në fund të tunelit”;
- **Story:** Foto e broshurave në Pejë me pamje nga Lumi dhe bjeshkët e Pejës, me përshkrimin “ Bjeshkë që të marrin frymën, lumi që ta qetëson shpirtin”;
- **Shpërndarja e broshurave të OLT-së:** tek të gjithë udhëtarët e trenit në relacionin Prishtinë-Pejë, me qëllim që të marrin informacione sa më shumë lidhur me trenin, si dhe të marrim informacione nga ata lidhur me ankesat kërkesat, sugjerimet, kënaqësitë e tyre
- **Postim/Story:** Njoftim për udhëtarët për mbajtjen e pastërtisë në tren;
- **Postim/Story:** Çmimet e linjës se trenit Prishtinë-Shëngjergj-Prishtinë;
- **Postim/Story:** Broshura për fushatë, ne lidhje me oraganizimet grupore per nxënës dhe mesimdhenes;
- **Postim/Story:** Foto me dy drejtorët e shkollave “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe dhe “Zejnel Salihu” Bardh i Madh, gjatë takimit për fushatën për promovimin e shërbimeve të kompanis Trainkos Sh.a;
- **Postim/Story:** Foto me drejtorët e shkollave, “Selman Riza” Fushë-Kosovë dhe “Lismiri” Lismir, gjatë takimit për fushatën promovuese;
- **Postim/Story:** Pyetësorë me pyetjen “Me kënd do te udhetoje nesër me tren”?
- **Postim/Story:** Foto me drejtorin e UBT-së, për matjen e kenaqshmerisë së klientave;
- **Foto profil:** Ndërrimi i foto profilit, për ndere të pavarësisë se Kosovës në të gjitha rrjetet sociale;
- **Postim/Story:** Pavarësia e Kosovës;
- **Postim/Story:** Vaktia e Ramazanit;
- **Postim/Story:** Kërkesë, ankesë apo sugjerim;
- **Postim/Story:** Takim me zyrtaret e Departamentit të sigurisë nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave të Kosovës;
- **Postim/Story:** OLT Prishtinë-Drenas;
- **Postim/Story:** Njoftim për anulimin e trenit ne linjën Pejë-Prishtinë, ne orarin e mëngjesit me datën 21.02.206;
- **Postim/Story:** Foto ne takimin qe kishim me shkollat “Vëllëzrit Frasheri” Dobrev dhe “Daut Bogujevci” Bresje;
- **Profil:** Ndërrim i foto profilit me llogo te Trainkosit;
- **Postim/Story:** Kërkesa për shfrytëzimin asetëve të Trainkos;
- **Përgatitja e Fllajerave** të udhëtareve të trenit, për organizime grupore;
- **Takim** pune me drejtorët e shkollave “Bajram Curri” Sllatinë e madhe dhe “Zejnel Salihu” Bardh i madh;
- **Takime:** me drejtorët e shkollave “Selman Riza” Fushë-Kosovë dhe “Lismiri” Lismir, gjatë takimit per fushatën promovuese;

- **Takim:** me kompanin e marketingut Tatamata për nje reklam qe do ta realizojnë për bankën Teb këtu ne zyret e Trainkosit
- **Takim:** me drejtorët e shkollave “Vëllezërit Frasheri” Dobrevë dhe “Daut Bogujevci” Bresje në kuader të fushëtes promovues të shërbimeve
- **Histori:** Oraret e linjave, Prishtinë-Pejë;
- **Histori:** Stop, respekto shenjat dhe rregullat;
- **Histori:** Kartolina e femrave të Kompanisë për nder të 8 Marsit (Boomerang);
- **Postim:** Epopeja e UÇK-së;
- **Postim:** 7 Marsi – Dita e mësuesve;
- **Postim:** 8 Marsi- Dita e grave;
- **Histori:** Pyetje për ndjekësit “Sa km përshkon treni Prishtinë–Pejë;
- **Postim:** SHFMU “Mihal Grameno” Aneksi 1 – Fushë Kosovë (foto);
- **Postim:** Pastrimi i jashtëm i vagoneve;
- **Postim:** SHFMU “Mihal Grameno” Aneksi 1 dhe Aneksi I-V Fushë Kosovë;
- **Postim:** Festa e Fitër Bajramit;
- **Histori:** Apliko për shfrytëzimin e aseteve, skano;
- **Histori:** Vërejtje për studenta;
- **Postim:** Pranvera ka ardh dhe natyra po merrë jete;
- **Postim:** Treni po afron;
- **Postim:** Beneficionet e udhëtimit me tren;
- **Postim:** Pensionimi i drejtorit të operatives Z. Sabit Berisha;
- **Komunikim gjatë gjithë kohës me ndjekësit**

Deri më tani numri i vizitoreve në faqet zyrtare te Trainkos Sh.A. :

**Facebook** arrin në **11 468** ndjekës.

**Instagram**, ku numri i anëtarëve ka arritur në **714** ndjekes.

**Viber Community** kemi gjithsej **332** anëtar aktiv.

**LinkedIn** kemi gjithsej **97** anëtar aktiv.

**Google Business** **398** ndërveprime të klientëve,

**Aktivitete të tjera:**

*Në kuadër të prezantimit të ofertës për udhëtim me tren në organizime grupor:* kemi zhvilluar takime me drejtuesit e shkollave “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe, “Zejnel Salihu” Bardh i Madh, “Selman Riza” Fushë-Kosovë, “Lismiri” në fsh-Lismir, “Vëllezërit Frasheri” Dobrevë, “Daut Bogujevci” Bresje Fushë-Kosovë “Mihal Grameno” Aneksi-1 dhe Aneksi I-

V Fushë Kosovë, me drejtorat e shkollave “Mihal Grameno” Aneksi-2 Fushë-Kosovë dhe “Laura Scott” Grabovc.

***Kërkesat që kemi pasur për shfrytëzim të asetëve, shërbimeve të veçanta gjatë periudhës janar – Mars 2026 janë si në vijim:***

Nr.	Data e shfrytëzimit	Institucioni	Lloji i Shfrytëzimit
1	16.02.2026	“Tatamata”	Xhirime
2	09.03.2026	SH.F.M.U “Mihail Grameno”	Udhëtime me tren në relacionin Fushë Kosovë-Prishtinë-Fushë Kosovë

***IX.4 Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera***

Transporti ndërkombëtarë i udhëtarëve e sidomos i mallrave tani për tani mund të bëhet vetëm përmes Linjës së 10-të hekurudhore e cila është e mbyllur që disa vite. Po ashtu kufizohet me mundësitë e gjendjes dhe bashkëpunimit me hekurudhat e shteteve që kufizohen me shtetin e Kosovës fillimisht dhe vazhdimi i linjave më tutje për plotësimin e kërkesave për klientët tanë. Përveç gjendjes politike që ndikon në realizimin e veprimtarisë që zhvillon Trainkos-i është edhe gjendja aktuale e linjave hekurudhore ekzistuese brenda vendit që ndërlidhet me gjendjen e infrastrukturës hekurudhore dhe potencialin e transportit që kërkohet dhe lidhja me hekurudhat e shteteve në regjion si parakusht për zhvillimin e biznesit që Ndërmarrja ofron. Vonesat që nuk kanë fund në përfundimin / fillimin e projekteve për modernizimin e Linjave hekurudhore pamundësojnë edhe shfrytëzimin e potencialit nga Portet Detare dhe Linjave tjera hekurudhore që mundësojnë transportin ndërkombëtarë të mallrave dhe udhëtarëve nga dhe në pjesën tjetër të Evropës dhe Botës. Bashkëpunimi me hekurudhat e Maqedonisë Veriore nuk kishte me qenë problem nëse kishte e pas transport, kurse me Republikën e Shqipërisë duhet të punohet shumë në fazën përgatitore pas përfundimit të studimit të fizibilitetit për Linjën hekurudhore që lidh Shqipërinë dhe Kosovën kur dihet se duhet të fillojë me procedura të radhës për shfrytëzimin e kësaj mundësie jetike me studimin e detajuar të projektit për ndërtimin e kësaj linje të rëndësishme hekurudhore. Trainkos-i duhet të ketë mbështetjen e domosdoshme për ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore paralel me zbatimin e projekteve në infrastrukturën hekurudhore dhe reformave të domosdoshme sipas kritereve të përcaktuara nga BE.

***IX.5 Pjesëmarrja e Trainkos-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme***

Në periudhën raportuese nuk ka pas ndonjë aktivitet direkt që ka të bëjë me iniciativat e BE-së.

Sektori hekurudhorë në Kosovë ka ngecje në plotësimin e kërkesave që rrjedhin nga BE për shtetet e Evropës Jug – Lindore, konkretisht shtetet e WB6. Për këtë edhe janë caktuar dhe definuar paketa hekurudhore për zhvillimin e transporti hekurudhorë. Midis viteve 2001 dhe 2016, u miratuan katër paketa legjislative me qëllim hapjen graduale të tregut të shërbimeve të transportit hekurudhor ndaj konkurrencës, bërjen e sistemeve kombëtare hekurudhore të ndërveprueshme dhe përcaktimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e një zone të vetme hekurudhore evropiane. Këto përfshijnë rregullat për tarifimin dhe ndarjen e kapaciteteve, dispozita të përbashkëta për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe certifikimin e drejtuesve të trenave, kërkesat e sigurisë, krijimin e Agjencisë Evropiane për Hekurudhat dhe organeve rregullative hekurudhore në çdo shtet anëtar, si dhe të drejtat e udhëtarëve që shfrytëzojnë transportin me hekurudhorë.

Kronologjia është si në vijim:

### **1. Paketa e parë hekurudhore (2001)**

Në korrik 1998, Komisioni paraqiti tre propozime të reja që synonin vetëm përmirësimin e efektivitetit të legjislacionit ekzistues. Më 26 shkurt 2001, Këshilli miratoi tre Direktivat e njohura si “paketa e infrastrukturës hekurudhore”.

### **2. Paketa e dytë hekurudhore (2004)**

Më 23 janar 2002, Komisioni Evropian propozoi një grup të ri masash (i njohur si “paketa e dytë hekurudhore”) që synonte rigjallërimin e hekurudhave përmes ndërtimit të shpejtë të një zone të integruar hekurudhore evropiane.

### **3. Paketa e tretë hekurudhore (2007)**

Më 3 mars 2004, Komisioni miratoi “paketën e tretë hekurudhore”, që përmban masa për rigjallërimin e hekurudhave në Evropë. Kjo paketë duhet të plotësojë kuadrin rregullator evropian për sektorin hekurudhor. Paketa vlen edhe për shtetet që janë kandidatë që pretendojnë të jenë pjesë e EU-së në të ardhmen.

### **4. Rishikimi i paketës së parë hekurudhore (Direktiva 2012/34/BE)**

Direktiva 2012/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 21 nëntor 2012, që krijon një zonë të vetme hekurudhore evropiane (rishikim).

### **5. Paketa e katërt hekurudhore (2016)**

Paketa e katërt hekurudhore është një grup prej 6 akteve legjislative të dizajnuara për të përfunduar tregun e vetëm për shërbimet hekurudhore (Zona e Vetme Hekurudhore Evropiane). Qëllimi i saj kryesor është rigjallërimi i sektorit hekurudhor dhe rritja e konkurrueshmërisë së tij ndaj mënyrave të tjera të transportit.

Si rezultat i paketave të lartë përmendura ka ndodhë edhe veprim i rëndësishëm i BE-së me nënshkrimin e Traktati për Transport, i nënshkruar në vitin 2014 e që vlen vetëm për shtetet e

WB6 me specifikat dhe kërkesat për reforma për të nxënë hapin me shtet tjera të BE-së. Viti 2025 por edhe fillimi i vitit 2026 ka rezultuar me aktivitete minimale në përfaqësimin dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me iniciativat BE-së për zhvillimin e sektorit hekurudhorë dhe Lëvizshmëri të Qëndrueshme sipas planeve zhvillimore. Kjo vazhdon të ndodhë edhe pas heqjes së sanksioneve për shtetin e Kosovës, por edhe përfaqësimi jo i denjë në entitete të krijuara nga BE për mbështetje të sektorit hekurudhorë reflektojnë në rezultate të pa dëshiruara për shtetin tonë.

#### ***IX.6 Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante për proceset që ndërlidhen me këto entitete***

Vazhdojnë angazhimet përhershme në plotësimin e obligimeve ligjore në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese vlen të veçohen:

- Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet e rregullta mujore për statistikave të transportit të realizuar nga TRAINKOS-i në ARH;
- Janë kompletuar të dhënat (statistikave në baza mujore) sipas kërkesës së ASK dhe kërkesa të rastit sipas obligimeve ligjore tjera nga ASK-së;
- Është përfunduar procesi i plotësimi të pyetësorit në përfshirjen e statistikave për transport me ASK-në sipas modelit dhe kërkesës së ekspertëve të EUROSTAT-it;
- Me zyrtarët e MIT-së është punuar në përmbylljen e vitit 2025 për OShP-në e vitit 2025 dhe fillimin e zbatimit të Marrëveshjes për OShP për vitin 2026;
- Sipas kërkesës së zyrtarëve të MIT-së është përgatitur baza e pjesës tekstuale nga dokumentet strategjike për hekurudha të vlefshme për takimin me FMN-në e që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit dhe
- Punë tjera të rastit që janë kërkuar nga entitetet që Trainkos-i koordinon veprimet dhe zhvillon proceset brenda sektorit hekurudhorë.

## X.SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2026 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, HK-Trainkos Sh.A. është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin dhe performancën operacionale të ndërmarrjes. Sfidat më të theksuara përfshijnë:

1. **Ndërprerja e qarkullimit** në linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit për shkak të vonesave në realizimin e projektit për modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore, që po zgjat më shumë se parashikimet fillestare.
2. **Mungesa e mjeteve lëvizëse** – me një flotë të vjetërsuar të lokomotivave dhe vagonëve, transporti i udhëtarëve vazhdon me trena klasikë në mungesë të trenave motorikë më efikasë dhe më ekonomikë.
3. **Kufizimet buxhetore**, që pengojnë investimet në rinovimin e flotës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për udhëtarët dhe mallrat.
4. **Pengesat ligjore dhe institucionale**, përfshirë mungesën e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor dhe boshllëqet në legjislacionin sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
5. **Trashëgimi e rëndë juridike nga ish-Hekurudhat e Kosovës**, me procese gjyqësore të pazgjidhura që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
6. **Mosfunksionimi i plotë i rrjetit hekurudhor vendor**, që kufizon zgjerimin e shërbimeve dhe ndikimin ekonomik të hekurudhës.
7. **Mungesë e kuadrit teknik profesional**, përballë një strukture të mbingarkuar me staf administrativ dhe moshë të lartë mesatare të personelit ekzistues.

Vetëm përmes një qasjeje të integruar dhe me mbështetje të qëndrueshme nga institucionet relevante, HK-Trainkos Sh.A. mund të rikthehet në rrugën e zhvillimit dhe të luajë një rol më të rëndësishëm në transportin kombëtar.

Fushë Kosovë,  
Prill 2026

Agron Statovci  
Kryeshef Ekzekutiv

